



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA E TIRANËS
AGJENCIA E PARQEVE DHE REKREACIONIT
DREJTORIA E PROKURIMIT PUBLIK

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(PARAPRAK)**

Drejtuar: Operatorit ekonomik “A l b G a r d e n” Sh.p.k

Adresa: Lagja “Skënderbeg” superstrada Lezhë-Tiranë, Lezhë

* * *

Procedura e prokurimit: **Procedurë e hapur e thjeshtuar, me mjete elektronike.**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: [shuma, objekti, kohëzgjatja e kontratës, etj.]

Qëllimi i kontratës është: **“Furnitura, farëra, fidanë e të tjera (e ndarë me lote)”, Loti II: “Blerje lule sezonale” me Nr. REF-09813-06-19-2024**

Fondi limit për Lotin e II: **2.000.000 (dymilion) lekë pa tvsh.**

Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: **Afati lëvrimit të luleve sezonale për llojet Petunia surfinia, Impatiens nuova guinea, Osteospermum dimorphotheca, Ganzia gazania gaertn, Begonia grandis dryand, Tulipan darëin, Margaritat daisy, Karafilat dianthus caryophyllus, Forium tenax do të jetë 45 ditë nga data e lidhjes së kontratës, ndërsa për Viola eittrockiana Gams mixcolor, Çiklamin cyclamen persicum, Cryzantema chrysanthemum morifolium, lule lakre brassica oleracea lëvrimit do të jetë në sezonin, 01 tetor- 30 Dhjetor 2024.**

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **02.07.2024**

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike Nr.32, datë 24.06.2024

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “A l b G a r d e n”Sh.p.k *NIPT-t: K37513520N*

Vlera 1.500.200 (një milion e pesëqind mijë e dyqind) lekë pa tvsh

2. Operatori ekonomik “AGRO - KORANI” Sh.p.k *NIPT-t: L13329801V*

Vlera 1.504.000 (një milion e pesëqind e katër mijë) lekë pa tvsh

3. Operatori ekonomik “Gjelbërimi 2000” Sh.p.k *NIPT-t: L21513012D*

Vlera 1 780 225 (një milion e shtatëqind e tetëdhjetë mijë e dyqind e njëzetë e pesë) lekë pa tvsh

4. Operatori ekonomik“T&J Konstruksion” shpk

NIPT-t: M29718101T1

Vlera 1 604 150 (një milion e gjashtëqind e katër mijë e njëqind e pesëdhjetë) lekë pa tvsh

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

Operatori ekonomik“T&J Konstruksion” shpk për arsyet e mëposhtme:

a) Në dokumentat e tenderit shtojca 7 “Kriteret e vecanta te kualifikimit”, Kapaciteti profesional, pika 2.1.2 percaktohet se operatoret ekonomik pjesëmarrës për tu kualifikuar per kete procedure prokurimi duhet te plotësojnë kriterin sa më poshtë:

2.1.2 -Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë **Certifikatë ISO 9001-2015** ose ekuivalentin, lidhur me sistemet e menaxhimit të cilësisë, **e cila të përfshijë objektin e prokurimit**, si dhe të jetë e vlefshme. Kjo certifikatë të jetë e lëshuar nga një organi i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë.(Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave që ka marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit.)

Në plotësim të këtij kriteri operatori ekonomik ka paraqitur dokumentacionin sa më poshte: Në dokumentacionin e ngarkuar në sistem Shoqëria “T&J Konstruksion” kaparaqitur ISO 9001-2015 me numër çertifikate SMC20240523ALTS dhe objekt:“Ndërtim, rikonstruksion dhe mirembajtje periodike të infrastruktures rrugore, ndërtesave civile dhe industriale, ujësjellësave, kanalizimeve, mbrojtje lumore, sistemime hidraulike, diga e bonifikime. Punime elektrike për shpërndarjen dhe transmetimin e energjisë elektrike të TU, TM e TL. Punime të inxhinierisë mjedisore, sinjalistikës rrugore dhe topo-gjeodezike. Prodhim betoni, elemente para fabrikate, materiale inerte e asfalt. Tregtim të materialeve të ndërtimit, elektrike, mekanike, hidraulike e industriale.”;Sektorët EA: 16, 28, 29.

Referuar objektit të procedurës ku OE i sipërcituar ka marrë pjesë objekti i ISO-s të ngarkuar në sistem nuk korrespondon me objektin e prokurimit dhe konkretisht me objektin: “Blerje furnitura, farëra, fidanë e të tjera (e ndarë në lote) “Loti II: Blerje Lule Sezonale” duke të çuar kështu në përfundimin se OE nuk e ka për mbushur kriteret e veçanta përkualifikim, kapaciteti teknik, pika **2.1.2**.

b) Në dokumentat e tenderit shtojca 7 “Kriteret e vecanta te kualifikimit”, Kapaciteti teknik pika 2.3.1 percaktohet se operatoret ekonomik pjesëmarrës për tu kualifikuar per kete procedure prokurimi duhet te plotësojnë kriterin sa më poshtë:

2.3.1 . Dëshmi per furnizime të mëparshme, të ngjashme, me objektin e prokurimit përcaktuar sipas Lotit të II-të të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates me vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate dhe konkretisht: **400.000 (katërqind mijë)** lekë pa TVSH.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Kur furnizimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e suksesshëm të kësaj kontrate ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

b) Kur furnizimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë duke paraqitur faturat përkatëse tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Në rast se operatori ekonomik ofertues merr pjesë në dy ose tre lote së bashku, vlera e furnizimeve të ngjashme, duhet të jetë jo më e vogël se 20 % e shumës së loteve ku oferton, të marra së bashku.*

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik operatori ekonomik “T&J Konstruksion” ka paraqitur sa mëposhtë:

- Vërtetim nr. 612 prot., datë 29.03.2024 (Bashkia Peqin) ku vërtetohet realizimi i kontratës : Furnizim dhe vendosje pemësh” me vlerë 840.000 lekë;
- Faturë tatimore nr. 5/2023 (Bashkia Peqin);

Sikundër specifikuar në germen (a) te pikës 2.3.1 është kërkuar që operatori ekonomik të paraqesë kontratën dhe vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetëror për realizimin e suksesshëm të kontratës. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar konstatohet se operatori ekonomik për kontratën e depozituar në spe në plotësim të dokumentacionit konkret të kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk ka paraqitur kontratën e lëshuar nga institucioni .

Gjithashtu objekti i kontratës furnizim dhe vendosje pemësh nuk është i ngjashëm me objektin e prokurimit ku është kërkuar blerje lulesh sezonale.

Sa më sipër operatori ekonomik “T&J Konstruksion” shpk nuk plotëson kriteret e vecanta për kualifikim, kapaciteti teknik dhe profesional pika 2.3.1, germa (a).

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë, se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. Në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Sa më sipër oferta e operatorit ekonomik “T&J Konstruksion” shpk konsiderohet e pavlefshme.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “**A l b G a r d e n**” shpk me NUIS - **K37513520N** dhe me Adrese: Lagja “Skënderbeg” superstrada Lezhë-Tiranë, Lezhë se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 1.500.200 (një milion e pesëqindmijë e dyqind) lekë **pa TVSH** është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.